



VENDIM

Nr.119 Datë 18.11.2011

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË
SHOQËRISË KESH SH.A PËR MIRATIMIN E PLANT TË
INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012 –
2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Cez Shperndarje sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin per miratimin Planit te Investimeve te KESH sha per vitin 2012

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë KESH sh.a për Planin e Investimeve per vitin 2012 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë KESH sh.a për miratimin e planit të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI